



**VENDIM**

**Nr. 154 Datë 07.12.2011**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC ULËZ SHKOPET SH.A PËR PERIUDHËN E  
TRETË RREGULLTORE**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, VKM Nr. 338, datë 19.03.2008, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, pika 4.13; neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec Ulëz Shkopet sh.a, për periudhën e tretë rregullatore,

**Vendosi:**

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Ulëz Shkopet sh.a për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 - 2014), do të jetë 2.72 leke/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e Hec Ulëz Shkopet sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.